



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2753/ 6 prot.

Datë 12/12/2023

V E N D I M
Nr. 1282/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12/12/2023, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “*Marrje automjete me qira*”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*AUTO FRANCE - AL*” SHPK me NIPT: K32313001H, me adresë: *AUTOSTRADA TIRANË - DURRËS KM 4, Kashar Tiranë*.

Autoriteti Kontraktor:

ALBPETROL SH.A.
Adresa: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë

mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL S.H.A.

II.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 08.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2753 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3578, e operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE - AL*” SHPK, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 8086/6 prot., datë 14.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2753/2 prot., datë 16.11.2023 me objekt “*Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “AUTO FRANCE – AL” ShPK për procedurën e prokurimit me objekt: “Marrje automjete me qira” me numër reference: REF-85607-10-27-2023*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE - AL*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK dhe me vendimin nr. 8086/5 prot., datë 13.11.2023 ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, me arsyetimet si më poshtë vijojnë:

[...]

ANKESË 1

Lidhur me;

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

...

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit ‘Viti prodhimit min viti 2022’ që e ka vendosur AK, është në përputhje me parimin e përcaktuar në dispozitën e LPP, pika 2 e nenit 36 në të cilën parashikohet që: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.”. Ndryshimi i vitit të prodhimit “min 2022” në “min 2023” që e kërkon OE ankimues do të krijonte pengesë për konkurrencën e hapur për prokurimin publik. Ndërkohë, KSHA lidhur me vitin e prodhimit të mjeteve arsyeton se minimumi i kërkuar është viti 2022 dhe kjo kërkesë nuk ndalon operatorët ekonomikë të interesuar të ofrojnë mjete prodhimi të vitit 2023.

ANKESË 2

Lidhur me;

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Ndërsa lidhur me ngjyrën e saj në fund autoriteti kontraktor citon se: Ngjyra e negociueshme në lidhjen e kontratës. Ky parashikim është i pabazuar sjell konfuzion tek operatorët ekonomik, sjell pasiguri pasi në çdo rast kosto dhe kërkesat e autoritetit kontraktor mund të ndryshojnë duke e ngarkuar OE pjesëmarrës me kosto të paparashikuara në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Është detyrim i autoritetit kontraktor të sigurojë që kërkesat (i) të jenë të shkruara në një mënyrë të tillë që të hapin prokurimin publik ndaj konkurrencës, (ii) të lejojnë akses të barabartë për ofertuesit, (iii) nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara në hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Për rrjedhojë ky kriter duhet rishikuar ose duke u përcaktuar ngjyra e mjetit ose duke mos e parashikuar një kërkim të tillë, për mos ta lënë atë evazive në momentin e negocimit.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Ngjyra e negociueshme në lidhjen e kontratës", nuk ndikon në karakteristikat e furnizimit që do të prokurohet, sikurse parashikohet në paragrafin 1, të nenit 36, të LPP, në të cilin përcaktohet se: "Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet."

Sa më sipër, ky vlerësim lidhet dhe me parimin e përcaktimit të kriterëve të njëjta ose të ngjashme për mallra të ngjashme, të tilla si automjet tipi 2 dhe 3 të kësaj procedure prokurimi, në të cilat nuk është përcaktuar kriteri i ngjyrës së automjetit.

KSHA vlerëson se për Autoritetin Kontraktor e rëndësishme është që mjetet të plotësojnë kërkesat e tij nga ana funksionale.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (ngjyra e automjeteve) për Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra, qëndron.

ANKESË 3

Lidhur me;

Automjet tipi 2 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra

...

Për sa i përket, dyerve të gabinës kërkohet me 4 dyer, kur në fakt nuk rezulton asnjë mjet i tillë me katër dyer. Në zhargon cilësohen me 4 dyer, por në certifikatat e konformitetit dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë gjithmonë rezultojnë me 5 dyer, duke përfshirë këtu dhe derën e bagazhit.

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ARSYETIMI I KSHA:

...

KSHA konstaton se në DST AK ka përcaktuar si kriter “Numri i dyerve 4”, ndërkohë që OE ankimues argumenton se ky kriter duhet të jetë “Numri i dyerve 5”. KSHA nga një vlerësim/kërkim në ËEB për specifikimet teknike të automjeteve objekt prokurimi për marka të ndryshme, konstaton se për këtë tip automjetesh numri i dyerve është 5 duke përfshirë 4 dyer anësore dhe derën e pasme, dera 5 që lidh hapësirën e magazinimi me vendqëndrimin e pasagjerëve.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (numri i dyerve) për Automjet tipi 2 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, qëndron.

ANKESË 4

Lidhur me;

Automjet tipi 3 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra

...

Për sa i përket, dyerve të gabinës kërkohet me 4 dyer, kur në fakt nuk rezulton asnjë mjet i tillë me katër dyer. Në zhargon cilësohen me 4 dyer, por në certifikatat e konformitetit dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë gjithmonë rezultojnë me 5 dyer, duke përfshirë këtu dhe derën e bagazhit.

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit ‘Viti prodhimit min viti 2022’ që e ka vendosur AK, është në përputhje me parimin e përcaktuar në dispozitën e LPP, pika 2 e nenit 36 në të cilën parashikohet që: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.”. Ndryshimi i vitit të prodhimit “min 2022” në “min 2023” që e kërkon OE ankimues do të krijonte pengesë për konkurrencën e hapur për prokurimin publik.

...

KSHA konstaton se në DST AK ka përcaktuar si kriter “Numri i dyerve 4”, ndërkohë që OE ankimues argumenton se ky kriter duhet të jetë “Numri i dyerve 5”. KSHA nga një vlerësim/kërkim në ËEB për specifikimet teknike të automjeteve objekt prokurimi për marka të ndryshme, konstaton se për këtë tip automjetesh numri i dyerve është 5 duke përfshirë 4 dyer anësore dhe derën e pasme, dera 5 që lidh hapësirën e magazinimi me vendqëndrimin e pasagjerëve.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (numri i dyerve) për Automjet tipi 3 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, qëndron. [...].

II.6. Me shkresën nr. 2753/3 prot., datë 01.12.2023 me objekt “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi i është drejtuar autoritetit kontraktor *ALBPETROL SH.A* dhe operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK me njoftimin për seancë dëgjimore me datë 05.12.2023, ora 12:00, në ambientet e KPP.

II.7. Në datën 05.12.2023, ora 12:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u zhvillua seanca dëgjimore në prani të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor *ALBPETROL SH.A* dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, dhe konkretisht për sa i përket kërkesave për modifikimin e specifikimeve teknike si në vijim: “

ANKESË 1

Lidhur me;

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ANKESË 2

Lidhur me;

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Ndërsa lidhur me ngjyrën e saj në fund autoriteti kontraktor citon se: Ngjyra e negocueshme në lidhjen e kontratës. Ky parashikim është i pabazuar sjell konfuzion tek operatorët ekonomik, sjell pasiguri pasi në çdo rast kosto dhe kërkesat e autoritetit kontraktor mund të ndryshojnë duke e ngarkuar OE pjesëmarrës me kosto të paparashikuara në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Është detyrim i autoritetit kontraktor të sigurojë që kërkesat (i) të jenë të shkruara në një mënyrë të tillë që të hapin prokurimin publik ndaj konkurrencës, (ii) të lejojnë akses të barabartë për ofertuesit, (iii) nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara në hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Për rrjedhojë ky kriter duhet rishikuar ose duke u përcaktuar ngjyra e mjetit ose duke mos e parashikuar një kërkim të tillë, për mos ta lënë atë evazive në momentin e negocimit.

ANKESË 3

Lidhur me;

Automjet tipi 2 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra

Për sa i përket, dyerve të gabinës kërkohet me 4 dyer, kur në fakt nuk rezulton asnjë mjet i tillë me katër dyer. Në zhargon cilësohen me 4 dyer, por në certifikatat e konformitetit dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë gjithmonë rezultojnë me 5 dyer, duke përfshirë këtu dhe derën e bagazhit.

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ANKESË 4

Lidhur me;

Automjet tipi 3 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra

Për sa i përket, dyerve të gabinës kërkohet me 4 dyer, kur në fakt nuk rezulton asnjë mjet i tillë me katër dyer. Në zhargon cilësohen me 4 dyer, por në certifikatat e konformitetit dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë gjithmonë rezultojnë me 5 dyer, duke përfshirë këtu dhe derën e bagazhit.

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK dhe me vendimin nr. 8086/5 prot datë 13.11.2023 ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, me arsyetimet si më poshtë vijojnë:

[...]

ANKESË 1

Lidhur me;

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

...

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit ‘Viti prodhimit min viti 2022’ që e ka vendosur AK, është në përputhje me parimin e përcaktuar në dispozitën e LPP, pika 2 e nenit 36 në të cilën parashikohet që: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.”. Ndryshimi i vitit të prodhimit “min 2022” në “min 2023” që e kërkon OE ankimues do të krijonte pengesë për konkurrencën e hapur për prokurimin publik. Ndërkohë, KSHA lidhur me vitin e prodhimit të mjeteve arsyeton se minimumi i kërkuar është viti 2022 dhe kjo kërkesë nuk ndalon operatorët ekonomikë të interesuar të ofrojnë mjete prodhimi të vitit 2023.

ANKESË 2

Lidhur me;

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Ndërsa lidhur me ngjyrën e saj në fund autoriteti kontraktor citon se: Ngjyra e negocueshme në lidhjen e kontratës. Ky parashikim është i pabazuar sjell konfuzion tek operatorët ekonomik, sjell pasiguri pasi në çdo rast kosto dhe kërkesat e autoritetit kontraktor mund të ndryshojnë duke e ngarkuar OE pjesëmarrës me kosto të paparashikuara në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Është detyrim i autoritetit kontraktor të sigurojë që kërkesat (i) të jenë të shkruara në një mënyrë të tillë që të hapin prokurimin publik ndaj konkurrencës, (ii) të lejojnë aksesin të barabartë për ofertuesit, (iii) nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara në hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Për rrjedhojë ky kriter duhet rishikuar ose duke u përcaktuar ngjyra e mjetit ose duke mos e parashikuar një kërkim të tillë, për mos ta lënë atë evazive në momentin e negocimit.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Ngjyra e negocueshme në lidhjen e kontratës", nuk ndikon në karakteristikat e furnizimit që do të prokurohet, sikurse parashikohet në paragrafin 1, të nenit 36, të LPP, në të cilin përcaktohet se: "Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet."

Sa më sipër, ky vlerësim lidhet dhe me parimin e përcaktimit të kriterëve të njëjta ose të ngjashme për mallra të ngjashme, të tilla si automjet tipi 2 dhe 3 të kësaj procedure prokurimi, në të cilat nuk është përcaktuar kriteri i ngjyrës së automjetit.

KSHA vlerëson se për Autoritetin Kontraktor e rëndësishme është që mjetet të plotësojnë kërkesat e tij nga ana funksionale.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (ngjyra e automjeteve) për Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërmbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra, qëndron.

ANKESË 3

Lidhur me;

Automjet tipi 2 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra

...

Për sa i përket, dyerve të gabinës kërkohet me 4 dyer, kur në fakt nuk rezulton asnjë mjet i tillë me katër dyer. Në zhargon cilësohen me 4 dyer, por në certifikatat e konformitetit dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë gjithmonë rezultojnë me 5 dyer, duke përfshirë këtu dhe derën e bagazhit.

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurt.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit ‘Viti prodhimit min viti 2022’ që e ka vendosur AK, është në përputhje me parimin e përcaktuar në dispozitën e LPP, pika 2 e nenit 36 në të cilën parashikohet që: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.”. Ndryshimi i vitit të prodhimit “min 2022” në “min 2023” që e kërkon OE ankimues do të krijonte pengesë për konkurrencën e hapur për prokurimin publik.

...

KSHA konstaton se në DST AK ka përcaktuar si kriter “Numri i dyerve 4”, ndërkohë që OE ankimues argumenton se ky kriter duhet të jetë “Numri i dyerve 5”. KSHA nga një vlerësim/kërkim në ËEB për specifikimet teknike të automjeteve objekt prokurimi për marka të ndryshme, konstaton se për këtë tip automjesh numri i dyerve është 5 duke përfshirë 4 dyer anësore dhe derën e pasme, dera 5 që lidh hapësirën e magazinimi me vendqëndrimin e pasagjerëve.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (numri i dyerve) për Automjet tipi 2 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, qëndron.

ANKESË 4

Lidhur me;

Automjet tipi 3 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra

...

Për sa i përket, dyerve të gabinës kërkohet me 4 dyer, kur në fakt nuk rezulton asnjë mjet i tillë me katër dyer. Në zhargon cilësohen me 4 dyer, por në certifikatat e konformitetit dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjetit në Republikën e Shqipërisë gjithmonë rezultojnë me 5 dyer, duke përfshirë këtu dhe derën e bagazhit.

Gjithashtu duke qenë se mendohet që fillimi i zbatimit të kontratës do të jetë viti 2024, që AK të marri mjete të vitit 2023, mjete të reja dhe rrjedhimisht më të sigurta.

ARSYETIMI I KSHA:

...

KSHA konstaton se në DST AK ka përcaktuar si kriter “Numri i dyerve 4”, ndërkohë që OE ankimues argumenton se ky kriter duhet të jetë “Numri i dyerve 5”. KSHA nga një vlerësim/kërkim në WEB për specifikimet teknike të automjeteve objekt prokurimi për marka të ndryshme, konstaton se për këtë tip automjesh numri i dyerve është 5 duke përfshirë 4 dyer anësore dhe derën e pasme, dera 5 që lidh hapësirën e magazinimi me vendqëndrimin e pasagjerëve.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (numri i dyerve) për Automjet tipi 3 SUV – Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, qëndron. [...].

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij,

një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 2753 protokollit, me datë 08.11.2023, e operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK për modifikimin e disa specifikimeve teknike për artikujt objekt-prokurimi, si në vijim: “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra; Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (një) e re me zero kilometra dhe Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (një), e re me zero kilometra*”, të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, “*Formulari i specifikimeve teknike*”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçovë, QPN Fier dhe QPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe QFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira(të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jenë "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehtë ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik .

Flota aktuale që kanë si qendrat e prodhimit dhe ato mbështetëse nuk arrijnë të mbulojnë punën voluminoze. Në programin e zhvillimit të shoqërisë Albpetrol sha të miratuar për vitin 2023 është parashikuar edhe marrja me qira operationale (leasing) të 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjeteve fuoristrada për një periudhë 4(katër) vjecare.

Specifikimet per automjetet:

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- | | |
|----------------------------------|-----------------------------|
| - Viti prodhimit/km | <u>Min viti 2022 / 0 km</u> |
| - Cilindrata | <u>Min 2200 cc.</u> |
| - Lenda djegese | Nafte. |
| - Fuqia motorike | <u>Min 110 Kw.</u> |
| - Numri i cilindrave | Min 4 |
| - Konsumi i kombinuar per 100 km | <u>Max 8 litra /100km.</u> |

Transmisioni:

- | | |
|------------------------------|----------|
| - Kutia e shpejtesise(Kamio) | Manuale. |
| - Terheqja | 4x4. |

Permasat e autovetures:

- | | |
|---------------------|-------------------|
| - Gjatesia | Min 5 200 mm |
| - Lartesia nga toka | <u>Min 200 mm</u> |
| - Gjeresia | Min 1 800 mm |
| - Lartesia | Min 1 700 mm |
| - Distanca aksiale | Min 3 000 mm |

Gabina:

- Numri i dyerve 4
- Numri i vendeve Min 4+1

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS.
- Sistem ASR, ESP
- Airbeg per shoferin dhe pasagjerin.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Radio
- Pedanat anesore
- Tempomat
- Disqe alumini min 16

Ngjyra e negocueshme ne lidhjen e kontrates

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km Min viti 2022 / 0 km
- Cilindrata Min 2200 cc.
- Lenda djegese Naftë.
- Fuqia motorike Min 140 kw.
- Numri i cilindrave Min 4
- Konsumi i kombinuar per 100km Max 10 litra /100km.

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kambio) Automatike
- Terheqja 4x4.

Permasat e autovetures:

- Gjatesia Min 4800 mm
- Lartesia nga toka Min 200 mm
- Gjeresia Min 1900 mm
- Lartesia Min 1800 mm
- Distanca aksiale Min 2800 mm

Gabina:

- Numri i dyerve 4
- Numri i vendeve Min 4+1

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR, EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.

- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18"
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesis per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome
- Sedilje lekure
- Kamera mbrapa

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates

Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km *Min viti 2022 / 0 km*
- Cilindrata *Min 1600 cc.*
- Lenda djegese *Nafte.*
- Fuqia motorike *Min 100 kw.*
- Numri i cilindrave *Min 4*
- Konsumi i kombinuar per 100km *Max 7 litra /100km.*

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kamio) *Automatike*
- Terheqja *2x4.*

Permasat e autovetures:

- Gjatesia *Min 4400 mm*
- Lartesia nga toka *Min 180 mm*
- Gjeresia *Min 1800 mm*
- Lartesia *Min 1600 mm*
- Distanca aksiale *Min 2600 mm*

Gabina:

- Numri i dyerve *4*
- Numri i vendeve *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR,EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional

- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesisë për timonin
- Funksion start & stop
- Set riparim gome

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 diteve nga lidhja e kontratës.

- *Oferta ekonomike e OE, duhet të ketë të përfshirë:*
 - Të gjitha shpenzimet e nevojshme për importin e automjeteve dhe pagesës së detyrimeve doganore, sipas legjislacionit në fuqi.
 - Të gjithë shpenzimet e nevojshme për regjistrimin e automjeteve pranë institucioneve përkatëse, targimin e automjeteve dhe dokumentacionin e duhur ligjor si: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, etj.
 - Të gjithë shpenzimet vjetore për taksat e qarkullimit, siguracionin e detyrueshëm TPL, kolaudimin, siguracionin Kasko, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.
 - Të gjithë shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, si:
 - Ndërrim i vajit të motorrit, filtrave të tjerë (karburantit, vajit, ajrit, kondicionerit, etj.) sipas afatit të manualit të automjetit.
 - Ndërrim i vajit të kambios, sipas afatit të manualit të automjetit.
 - Ndërrimin e pjesëve të konsumit të automjeteve, në varësi të përdorimit të tyre, si ferrota, alkol frenash, alkol të sistemit të drejtimit, etj.
 - Ndërrimin e gomave sipas normativës së konsumit të ndërrimit pas përshkruarjes së kilometrave përkatëse.
 - Riparimin e automjeteve kur kjo është e nevojshme.

Marrja me qira e automjeteve kërkohet për një periudhë 48 (dyzet e tetë) muaj nga data e dorëzimit të automjeteve.

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruajë të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkuorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marrja me qira operacionale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Marrja me qira e mjeteve do të jetë për një periudhë 48 muaj, pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për 48 muaj me një planifikim 12 muaj afërsisht 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit. Mbi këtë vlerësim Albpetrol sha ka planifikuar marrjen me qira operacionale të një sasie mjetesh rrugore.

Gjithashtu Ofertuesi ka për detyrë:

- a. Menaxhimin e gjithë dokumentacionit të makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj.
- b. Menaxhimin e gjithë procesit të sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash.
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit.
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike.
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve.
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje.
- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira me specifikimet teknike në DST) brenda 48 oreve.
- h. Asistenca teknike e ofruar dhe shërbimi i emergjences 24 ore
- i. Menaxhim flote me anë të inkorporimit të sistemit GPS.

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, autoriteti kontraktor argumentuar përcaktimin e specifikimeve teknike objekt-ankimi si më poshtë vijon:

“II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.”.

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

III.2.6. Neni 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

- “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*
- 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*
- 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.".

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto

karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që

kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim” Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshtetshmëri të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për praninë të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshtetshmëri të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.” Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni Evropian vs. Mbretëria e Holandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashitjnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin

publik” është përafuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një 18 vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet stricto-sensu vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Gjithashtu, Komisioni thekson, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kështu, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike nuk mund të nisët vetëm nga procedura analoge të zhvilluara më parë nga po i njëjti autoritet kontraktor ose nga autoritete të tjera kontraktore homologe, ose eprore, por në përputhje me parashikimet e ligjit.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe

në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” se: “2 *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*”. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.2.9. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit sqarohet se:

“Lidhur me:

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Cilindrata min 2200 cc**", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, e pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA arsyeton se kërkesa e OE ankimes për ndryshimin e cilindratës së kërkuar në maksimumin 2000 cc është e paargumentuar dhe bie ndesh edhe me kërkesat e tij për tipet e tjera të mjeteve të kërkuara në pikat e tjetra të ankesës. Për këto mjete OE ankimes kërkon që cilindrata e mjetit të kërkohet në minimumin e një vlere të caktuar dhe jo në maksimumin e saj. Pra, OE ankimes është konfuz në kërkesën e tij dhe nuk është koherent, në këtë rast kërkon që cilindrata të jetë në maksimumin 2000 cc, duke ofruar mundësinë e ofertimit të mjeteve me cilindrate shumë më të ulët, gjë që bie ndesh me qëllimin, logjikën dhe objektin e kontratës.

KSHA konstaton e OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik për të kundërshtuar vendosjen e kriterit "**Cilindrata min 2200 cc**", për të cilin kërkon ndryshimin në "**Cilindrata max 2000 cc**". OE ankimes jep vetëm opinionin se ndryshimi i këtij kriteri, sipas tij, do të sjellë "ulje të ndotjes në mjedis sipas standardeve të Bashkimit Europian për Ndotjen në Mjedis nga mjetet motorike", pa iu referuar standardit të BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "**Cilindrata min 2200 cc**" me tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Fuqia motorike Min 110 Kw**", është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknikë të automjeteve - objekt prokurimi dhe ky kriter në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA vlerëson se arsyetimi për ndryshimin e cilindratës vlen edhe për fuqinë motorike të mjetit për të cilën OE ankimes kërkon të ulet nga 110 kw në 100 kw, duke e argumentuar me uljen e ndotjes, por pa cituar se sa do të jetë kjo ulje e ndotjes.

KSHA konstaton se OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik që kundërshton vendosjen e kriterit "**Fuqia motorike Min 110 Kw**", për të cilin kërkon ndryshimin në "**Fuqia motorike Min 100 Kë**". OE ankimes jep vetëm opinionin se: "Me uljen e cilindratës çmojmë se duhet ulur dhe fuqia motorike minimale e kërkuar në minimumin që duhet kërkuar 100 kë pasi do të pasillte dhe ulje të ndotjes sipas standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Europian", pa iu referuar

standardit apo kërkesës së BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Fuqia motorike Min 110 Kw", për më tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore.

KSHA vlerëson se arsytim i OE ankimues në lidhje me ndryshimin e kriterit "**Konsumi i kombinuar për 100 km Max 8 litra /100km.**", bie ndesh edhe me kërkesën e tij për rritjen e konsumit të kombinuar të karburantit nga 8 litra/100 km në 11 litra/100 kilometra. Kërkesa për rritjen e konsumit të karburantit, ndërkohë që kërkohet ulja e cilindratës dhe njëkohësisht e fuqisë motorrike të mjetit, është e pakuptimtë, pasi ulja e cilindratës dhe njëkohësisht e fuqisë motorrike do të sillte ulje të konsumit të karburantit dhe jo rritje të tij. Për këtë arsye gjykojmë se kërkesa e ankimuesit për këtë pikë është joreale dhe për më tepër ankimuesi nuk ka argumentuar se përse duhet rritur niveli i konsumit të karburantit në 11 litra/100 km. Theksojmë gjithashtu se kjo rritje do të sillte kosto të mëtejshme për Autoritetin Kontraktor gjate zbatimit të kontratës.

- KSHA konstaton se në procesverbalin "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", AK ka përcaktuar se: "Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, OPN Kuçovë, OPN Fier dhe OPM Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe OFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jenë "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehtë ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Lartësia nga toka Min 200 mm**", është kriter që lidhet me parametra të tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime. KSHA, nga një vlerësim/kërkim në wëb për specifikimet teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standarde e automjetit nga toka (Ground Clearance) për mjete me parametra teknike, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 200 mm dhe jo 180 mm, sikurse pretendon në ankesë OE.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (kriteret teknike/përmasat) për Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërmbëdhjetë) copë të reja me zero Kilometra, nuk qëndron.

Lidhur me:

Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Viti prodhimit min viti 2022**", që e ka vendosur AK, është në përputhje me parimin e përcaktuar në dispozitën e LPP, pikën 2 të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim i barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.". Ndryshimi i vitit të prodhimit nga "min viti 2022" në "min viti 2023", që e kërkon OE ankimues, do të krijonte pengesë për konkurrencën e hapur për prokurimin publik.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Cilindrata min 2200 cc**", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të

ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA konstaton e OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik që kundërshton vendosjen e kriterit "Cilindrata min 2200 cc", për të cilin kërkon ndryshimin në "Cilindrata min 2150 cc". OE ankimes jep vetëm opinionin se ndryshimi i këtij kriteri do të sjellë "ulje të ndotjes në mjedis sipas standardeve të Bashkimit Europian për Ndotjen në Mjedis nga mjetet motorike", pa iu referuar standardit të BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Cilindrata min 2200 cc", për më tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore. Gjithashtu, arsyetimet se AK në kërkesat për kualifikim ka kërkuar të paraqitet katalog për të vërtetuar specifikimet teknike të mjeteve dhe argumenton se në çdo katalog të çdo mjeti cilindrata është e shprehur me vlera fikse e cilindrates.

KSHA konstaton se në procesverbalin "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", AK ka përcaktuar se "Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçove, QPN Fier dhe OPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe OFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jene "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehte ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik."

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Lartësia nga toka Min 200 mm", është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime. KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikime teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standarde e automjetit nga toka (Ground Clearance) për mjete me parametra teknike, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 200 mm dhe jo 180 mm, sikurse pretendon në ankese OE.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Lartësia Min 1800 mm" është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime. KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikimet teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standard e automjetit nga toka (Height) për mjete me parametra teknike, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 1800 mm dhe jo 1690 mm, sikurse pretendon në ankesë OE.

KSHA vlerëson se lidhur me aksesoret shtesë për nuancën e xhamave apo errësimin e xhamave të prapëm argumentojmë se këta janë aksesore standard që plotësohen nga pjesa më e madhe e prodhuesve të automjeteve. Për Autoritetin Kontraktor e rëndësishme është që mjetet të plotësojnë kërkesat e tij nga ana funksionale dhe nuk është kërkuar përqindja e nuancës apo errësimin të xhamave, parametra që përcaktohen me akte nenligjore.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (kriteret teknike/përmasat) për Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, nuk qëndron.

Lidhur me:

Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (një) e re me zero kilometra.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Viti prodhimit min viti 2022", që e ka vendosur AK, është në përputhje me parimin e përcaktuar në dispozitën e LPP, pikën 2 të neni 36, në të cilën parashikohet që: "2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim i barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në

prokurimin publik.". Ndryshimi i vitit të prodhimit nga "min viti 2022" në "min viti 2023", që e kërkon OE ankimes, do të krijonte pengesë për konkurrencën e hapur për prokurimin publik.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Cilindrata min 1600 cc**", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA konstaton e OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik që kundërshton vendosjen e kriterit "Cilindrata min 1600 cc", për të cilin kërkon ndryshimin në "Cilindrata min 1580 cc". OE ankimes jep vetëm opinionin se ndryshimi i këtij kriteri do të sjellë "ulje të ndotjes në mjedis sipas standardeve të Bashkimit Europian për Ndotjen në Mjedis nga mjetet motorike", pa iu referuar standardit të BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Cilindrata min 1600 cc", për më tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore. Gjithashtu, arsyetohet se AK në kërkesat për kualifikim ka kërkuar të paraqitet katalog për të vërtetuar specifikimet teknike të mjeteve dhe argumenton se në çdo katalog të çdo mjeti cilindrata është e shprehur me vlera fikse e cilindrates.

KSHA konstaton se në procesverbalin "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", AK ka përcaktuar se "Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçove, QPN Fier dhe OPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe OFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jene "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehte ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik."

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Lartësia nga toka Min 180 mm", është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime. KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikime teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standarde e automjetit nga toka (Ground Clearance) për mjete me parametra teknike, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 180 mm dhe jo 170 mm, sikurse pretendon në ankese OE.

KSHA vlerëson se lidhur me aksesorët shtesë për nuancën e xhamave apo errësimin e xhamave të prapëm argumentohet se këta janë aksesore standard që plotësohen nga pjesa më e madhe e prodhuesve të automjeteve. Për Autoritetin Kontraktor e rëndësishme është që mjetet të plotësojnë kërkesat e tij nga ana funksionale dhe nuk është kërkuar përqindja e nuancës apo errësimit të xhamave, parametra që përcaktohen me akte nenligjore.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (kriteret teknike/përmasat) për Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, nuk qëndron."

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat, janë konfuze dhe të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga

pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të parashtrorjnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit.

III.2.11.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "AUTO FRANCE – AL" SHPK për sa i përket modifikimit të specifikimit teknik për vitin e prodhimit të automjeteve "Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra" dhe "Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra" të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, KPP vëren, se ankimuesi në parashtrimet në ankesë pretendon ndryshimin e këtij specifikimi teknik, duke kërkuar që kufiri minimal i vitit të prodhimit të këtyre automjeteve duhet të jetë viti 2023, ndërkohë që lidhur me këtë pretendim të ankimuesit KPP gjykon, se referuar dhe argumentimit të bërë nga komisioni i shqyrtimit të ankesës në kthim - përgjigjen drejtuar operatorit ekonomik ankimues në procedurën objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike si thelbësore dhe të lidhura ngushtësisht me nevojën e autoritetit kontraktor për të siguruar automjete të reja, duke siguruar një nivel sigurie të përcaktuar qartë lidhur me nevojën që ka për të operuar në terrene të vështira për transportin e njerëzve dhe materialeve. Gjithashtu, KPP gjykon se përcaktimi i vitit të prodhimit dhe konkretisht i vitit 2022 nuk është diskriminues dhe nuk ul konkurrencën, pasi ofertuesit mund të paraqesin ofertë duke ofruar automjete të prodhuara në vitin 2023. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me automjetet e mësipërme të kërkuar, duke respektuar nenin 36 të LPP-së.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

III.3.9.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "AUTO FRANCE – AL" SHPK për sa i përket modifikimit të specifikimit teknik lidhur me parametrin e "Cilindratës" të automjeteve "Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)", "Automjet tipi 2" dhe "Automjet tipi 3 SUV" të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ky i fundit ka parashtruar argumente të bazuara, në lidhje me kërkesat e mësipërme. Nga shqyrtimi i procesverbalit "PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM", të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht hartimin dhe vendosjen e këtij specifikimi teknik. Nga ana tjetër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave lidhur me këtë pretendim të ankimuesit me vendimin nr. 8086/5 prot., datë 13.11.2023 ka argumentuar se: "**Lidhur me: Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra.**

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Cilindrata min 2200 cc", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, e pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të

ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA arsyeton se kërkesa e OE ankimes për ndryshimin e cilindrates së kërkuar në maksimumi 2000 cc është e paargumentuar dhe bie ndesh edhe me kërkesat e tij për tipet e tjera të mjeteve të kërkuara në pikat e tjetra të ankesës. Për këto mjete OE ankimes kërkon që cilindrata e mjetit të kërkohet në minimumin e një vlere të caktuar dhe jo në maksimumin e saj. Pra, OE ankimes është konfuz në kërkesën e tij dhe nuk është koherent, në këtë rast kërkon që cilindrata të jetë në maksimumin 2000 cc, duke ofruar mundësinë e ofertimit të mjeteve me cilindrata shumë më të ulët, gjë që bie ndesh me qëllimin, logjikën dhe objektin e kontratës.

KSHA konstaton e OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik për të kundërshtuar vendosjen e kriterit "Cilindrata min 2200 cc", për të cilin kërkon ndryshimin në "Cilindrata max 2000 cc". OE ankimes jep vetëm opinionin se ndryshimi i këtij kriteri, sipas tij, do të sjellë "ulje të ndotjes në mjedis sipas standardeve të Bashkimit Europian për Ndotjen në Mjedis nga mjetet motorike", pa iu referuar standardit të BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Cilindrata min 2200 cc" me tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore.

*KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Cilindrata min 2200 cc**", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."*

KSHA konstaton e OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik që kundërshton vendosjen e kriterit "Cilindrata min 2200 cc", për të cilin kërkon ndryshimin në "Cilindrata min 2150 cc". OE ankimes jep vetëm opinionin se ndryshimi i këtij kriteri do të sjellë "ulje të ndotjes në mjedis sipas standardeve të Bashkimit Europian për Ndotjen në Mjedis nga mjetet motorike", pa iu referuar standardit të BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Cilindrata min 2200 cc", për më tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore. Gjithashtu, arsyetohet se AK në kërkesat për kualifikim ka kërkuar të paraqitet katalog për të vërtetuar specifikimet teknike të mjeteve dhe argumenton se në çdo katalog të çdo mjeti cilindrata është e shprehur me vlera fikse e cilindrates.

KSHA konstaton se në procesverbalin "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", AK ka përcaktuar se "Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçove, QPN Fier dhe OPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe OFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jene "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehte ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik."

*KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Cilindrata min 1600 cc**", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të*

ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA konstaton e OE ankimes nuk jep asnjë argument teknik që kundërshton vendosjen e kriterit "Cilindrata min 1600 cc", për të cilin kërkon ndryshimin në "Cilindrata min 1580 cc". OE ankimes jep vetëm opinionin se ndryshimi i këtij kriteri do të sjellë "ulje të ndotjes në mjedis sipas standardeve të Bashkimit Europian për Ndotjen në Mjedis nga mjetet motorike", pa iu referuar standardit të BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Cilindrata min 1600 cc", për më tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore. Gjithashtu, arsyetojmë se AK në kërkesat për kualifikim ka kërkuar të paraqitet katalog për të vërtetuar specifikimet teknike të mjeteve dhe argumenton se në çdo katalog të çdo mjeti cilindrata është e shprehur me vlera fikse e cilindrates.

KSHA konstaton se në procesverbalin "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", AK ka përcaktuar se "Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçove, QPN Fier dhe OPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe OFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jene "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehte ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik.", duke mos arritur që të argumentojë se ku është mbështetur në hartimin dhe përcaktimin e këtij specifikimi Teknik, si dhe nuk ka arritur të argumentojë teknikisht në terma funksionalë se përse minimumi i madhësisë së cilindrates është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe se si ky specifikim është i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të autoritetit kontraktor lidhur me realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Lidhur me metodologjinë e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për hartimin e këtij specifikimi Teknik për automjetet objekt-prokurimi, Komisioni më datë 05.12.2023, ora 12:00 zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe të ankimesit, ku pyetjeve të mëposhtme të Komisionit si në vijim: "1- Si janë hartuar specifikimet teknike nga ana e autoritetit kontraktor për mallrat objekt-prokurimi, sipas kontratës së shërbimit të kërkuar?; 2- Cilës prej metodave të parashikuara në nenin 36 të LPP-së, i është referuar AK në hartimin e specifikimeve teknike? Dhe 3- A ka kryer AK studim tregu në përputhje me parashikimin e nenit 35 të LPP-së dhe gjatë hartimit të këtyre specifikimeve teknike dhe studimit të tregut (në rast se është kryer nga ana e AK-së) a është vlerësuar se në mënyrë të kombinuar këto specifikime teknike mund të çojnë drejt një marke të posaçme?", përfaqësuesit e autoritetit kontraktor bënë me dije se: "Në hartimin e këtij specifikimi teknik i janë referuar standardeve që ka përcaktuar Ligji i Prokurimit Publik, si dhe kanë përdorur një standard të kombinuar. Studimi i tregut i bërë për hartimin e specifikimit teknik nuk është i dokumentuar, por në të gjitha specifikimet është vendosur minimum dhe nuk është vendosur kufi nga një vlerë në një vlerë, në mënyrë që të mbyllet, të shtrembërohet ose që të drejtohet drejt një marke të caktuar. Ne nuk e besojmë këtë pretendim të ankimesit, sepse në ankesën e shprehur vlerësohet fakti që do të jetë një cilindrata më e vogël do të prodhojë ndotje më pak. Unë nuk e besoj këtë pretendim për faktin se sot janë vendosur disa standarde që edhe Shqipëria i gëzon këto. Pavarësisht nga viti prodhimit, i cili sigurisht përmirësohet në shumë standarde, ka një standard të caktuar edhe për çështjen e ndotjes dhe përderisa mjetet lejohen të atij standardi (pavarësisht vitit të prodhimit) unë nuk e kuptoj dot se si një mjet me cilindrata më të vogël do të prodhojë ndotje më pak. Jo, në gjykimin tim si ekspert ndotjen nuk e krijon cilindrata, por gjendja teknike e motorrit, pra nëse një motor

është i rënduar ose i konsumuar ai do të krijojë ndotje më shumë, nëse ne kërkojmë mjete të reja që sigurisht kanë standardin e tyre në raport me ndotjen dhe përse ne kemi një cilindratë kufi, pasi cilindratat shkojnë edhe më lartë 3000, 4000, 5000, 6000, Ne kemi kërkuar një që i përshtatet asaj që thamë edhe më përpara, ku rrugët tona janë të vështira dhe këto mjete të piketuara nga ana jonë për të përballuar ngarkesë me pajisje dhe punëtorë në këto rrugë. Pra unë gjykoj se pretendimi i ankimuesit për cilindratën nuk qëndron fare.”, por nga ana tjetër në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesi i autoritetit kontraktor u shpreh se: “Nevojat e autoritetit kontraktor absolutisht mund të plotësohen edhe me standart më të vogël, por nuk do të kenë garanci për ngarkesën, për shpejtësinë, për gjëra të tjera.”, duke mos arritur që të argumentojë se si e ka bërë studimin e tregut, se cilën metodë të përcaktuar në nenin 36 të LPP-së ka përdorur, si dhe se si ndikon pranimi i pretendimit të ankimuesit në terma funksionale, ndërkohë që vetë përfaqësuesi i autoritetit kontraktor në seancë pranon që qëllimi për të cilin enti prokurues po i merr këto automjete me qira mund të realizohet edhe me automjete që kanë cilindratë më të vogël.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon, se për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë do të sigurojnë mall cilësor në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, por një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të justifikojë kërkesën për “Cilindratën” për secilën prej automjeteve objekt-prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP-së si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuzë, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin teknik të “Cilindratës” për automjetet “Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)”, “Automjet tipi 2” dhe “Automjet tipi 3 SUV” të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, sipas pretendimeve të ankimuesit.

Pretendimet e operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK qëndrojnë.

III.3.9.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK për sa i përket modifikimit të specifikimit teknik lidhur me parametrin “*Fuqia motorike*” të automjetit “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*”, të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ky i fundit ka parashtruar argumente të bazuara, në lidhje me kërkesat e mësipërme. Nga shqyrtimi i procesverbalit “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht hartimin dhe vendosjen e këtij specifikimi teknik. Nga ana tjetër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave lidhur me këtë pretendim të ankimuesit me vendimin nr. 8086/5 prot., datë 13.11.2023 ka argumentuar se: “*Lidhur me:*

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërmbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Fuqia motorike Min 110 Kw", është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknikë të automjeteve - objekt prokurimi dhe ky kriter në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, i pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj."

KSHA vlerëson se arsyetimi për ndryshimin e cilindratës vlen edhe për fuqinë motorike të mjetit për të cilën OE ankimues kërkon të ulet nga 110 kë në 100 kë, duke e argumentuar me uljen e ndotjes, por pa cituar se sa do të jetë kjo ulje e ndotjes.

KSHA konstaton se OE ankimues nuk jep asnjë argument teknik që kundërshton vendosjen e kriterit "Fuqia motorike Min 110 Kw", për të cilin kërkon ndryshimin në "Fuqia motorike Min 100 Kë". OE ankimues jep vetëm opinionin se: "Me uljen e cilindratës çmohet se duhet ulur dhe fuqia motorike minimale e kërkuar në minimumin që duhet kërkuar 100 kë pasi do të pasillte dhe ulje të ndotjes sipas standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Europian", pa iu referuar standardit apo kërkesës së BE për mjedisin me të cilin bie ndesh kriteri i vendosur nga AK "Fuqia motorike Min 110 Kw", për më tepër që automjetet - objekt prokurimi janë prodhim i vendeve evropiane apo ndërkombëtare, që operojnë brenda standardeve më të larta, përfshi dhe ato mjedisore.", duke mos arritur që të argumentojë se ku është mbështetur në hartimin dhe përcaktimin e këtij specifikimi teknik, si dhe nuk ka arritur të argumentojë teknikisht në terma funksionalë se përse minimumi i fuqisë motorike është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe se si ky specifikim është i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të autoritetit kontraktor lidhur me realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Lidhur me metodologjinë e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për hartimin e këtij specifikimi Teknik për automjetet objekt-prokurimi, Komisioni më datë 05.12.2023, ora 12:00 zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe të ankimuesit, ku referuar pyetjeve të mëposhtme të Komisionit si në vijim: “1- Si janë hartuar specifikimet teknike nga ana e autoritetit kontraktor për mallrat objekt-prokurimi, sipas kontratës së shërbimit të kërkuar?; 2- Cilës prej metodave të parashikuara në nenin 36 të LPP-së, i është referuar AK në hartimin e specifikimeve teknike? Dhe 3- A ka kryer AK studim tregu në përputhje me parashikimin e nenit

35 të LPP-së dhe gjatë hartimit të këtyre specifikimeve teknike dhe studimit të tregut (në rast se është kryer nga ana e AK-së) a është vlerësuar se në mënyrë të kombinuar këto specifikime teknike mund të çojnë drejt një marke të posaçme?”, përfaqësuesit e autoritetit kontraktor bënë me dije se: “Në hartimin e këtij specifikimi teknik i janë referuar standardeve që ka përcaktuar Ligji i Prokurimit Publik, si dhe kanë përdorur një standard të kombinuar. Studimi i tregut i bërë për hartimin e specifikimit teknik nuk është i dokumentuar, por në të gjitha specifikimet është vendosur minimum dhe nuk është vendosur kufi nga një vlerë në një vlerë, në mënyrë që të mbyllet, të shtrembërohet ose që të drejtohet drejt një marke të caktuar. Këto janë rrjedhoja logjike, pasi kërkesa e ankimuesit për një cilindratë më të ulët do të çojë rrjedhimisht në një fuqi motorrike më të vogël. Duket sikur OE që është ankimuar kërkon për veten e vetë, duke kërkuar që të ulë cilindratën dhe rrjedhimisht të ulë edhe fuqinë motorrike. Ne po gjykojmë ngarkesën p.sh., mjetet tona në rrugë të kategorisë 5, 6 dhe 7 të ngarkuara me ngarkesa të karakterit metalik në rrugë malore dhe të rrezikshme, në rrugë jo të mirëmbajtura, në rrugë të shtruara më çakull, në rrugë me gropa ky gomat hyjnë deri në gjysmë metri makina (se te tilla janë operacionet që kryen nafta) dhe që sigurisht ne kemi kombinuar një zgjedhje tonën, duke pranuar që mjetet me minimumin e karakteristikave të përcaktuara përballojnë operacionet e sipërpërmendura. Ndërsa nëse këto specifikime do të ulëshin edhe më poshtë sipas pretendimeve të ankimuesit mjetet do të dëmtoheshin në këto rrugë dhe do të ishim në rrishtun e mungesës së realizimit të shërbimit.”, duke mos arritur që të argumentojë se si e ka bërë studimin e tregut, se cilën metodë të përcaktuar në nenin 36 të LPP-së ka përdorur, si dhe se si ndikon pranimi i pretendimit të ankimuesit në terma funksionale, ndërkohë që vetë përfaqësuesi i autoritetit kontraktor në seancë pranoi, se fuqia motorrike më ulët për këtë automjet nuk çon automatikisht në mosrealizimin e qëllimit të entit prokurues, por shprehet në mënyrë hipotetike se mund të dëmtoheshin këto automjete, ndërkohë që referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit, operatori ekonomik i shpallur fitues ka detyrimin që me shpenzimet e veta të riparojë çdo difekt apo dëmtim që pëson automjeti.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon, se për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë do të sigurojnë mall cilësor në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, por një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të justifikojë kërkesën për “Fuqinë motorrike” për automjetin “Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)” objekt-prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP-së si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në

përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin teknik “Fuqia motorrike” për automjetin “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*” të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, sipas pretendimeve të ankimesit.

Pretendimi i operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK qëndron.

III.3.9.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK për sa i përket modifikimit të specifikimit teknik lidhur me parametrin “***Konsumi i kombinuar për 100 km***” të automjetit “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*”, të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ky i fundit ka parashtruar argumente të bazuara, në lidhje me kërkesat e mësipërme. Nga shqyrtimi i procesverbalit “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht hartimin dhe vendosjen e këtij specifikimi teknik. Nga ana tjetër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave lidhur me këtë pretendim të ankimesit me vendimin nr. 8086/5 prot., datë 13.11.2023 ka argumentuar se: “***Lidhur me:***

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra.

KSHA vlerëson se arsytimi i OE ankimes në lidhje me ndryshimin e kriterit "Konsumi i kombinuar per 100 km Max 8 litra /100km.", bie ndesh edhe me kërkesën e tij për rritjen e konsumit të kombinuar të karburantit nga 8 litra/100 km në 11 litra/100 kilometra. Kërkesa për rritjen e konsumit të karburantit, ndërkohë që kerkohet ulja e cilindratës dhe njëkohësisht e fuqisë motorrike të mjetit, është e pakuptimtë, pasi ulja e cilindratës dhe njëkohësisht e fuqisë motorrike do të sillte ulje të konsumit të karburantit dhe jo rritje të tij. Për këtë arsye gjykojmë se kërkesa e ankimesit për këtë pikë është joreale dhe për më tepër ankimesi nuk ka argumentuar se përse duhet rritur niveli i konsumit të karburantit në 11 litra/100 km. Theksojmë gjithashtu se kjo rritje do të sillte kosto të mëtejshme për Autoritetin Kontraktor gjate zbatimit të kontratës.", duke mos arritur që të argumentojë se ku është mbështetur në hartimin dhe përcaktimin e këtij specifikimi teknik, si dhe nuk ka arritur të argumentojë teknikisht në terma funksionalë se përse minimumi i fuqisë motorrike është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe se si ky specifikim është i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të autoritetit kontraktor lidhur me realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Lidhur me metodologjinë e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për hartimin e këtij specifikimi Teknik për automjetet objekt-prokurimi, Komisioni më datë 05.12.2023, ora 12:00 zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe të ankimesit, ku referuar pyetjeve të mëposhtme të Komisionit si në vijim: “1- Si janë hartuar specifikimet teknike nga ana e autoritetit kontraktor për mallrat objekt-prokurimi, sipas kontratës së shërbimit të kërkuar?; 2- Cilës prej metodave të parashikuara në nenin 36 të LPP-së, i është referuar AK në hartimin e specifikimeve teknike? Dhe 3- A ka kryer AK studim tregu në përputhje me parashikimin e nenit

35 të LPP-së dhe gjatë hartimit të këtyre specifikimeve teknike dhe studimit të tregut (në rast se është kryer nga ana e AK-së) a është vlerësuar se në mënyrë të kombinuar këto specifikime teknike mund të çojnë drejt një marke të posaçme? dhe 4- Si ka arritur AK në këtë konkluzion kur ka hartuar këtë specifikim Teknik lidhur me “Konsumi i kombinuar për 100 km: Max 8 litra /100km”?”, përfaqësuesit e autoritetit kontraktor bënë me dije se: “Në hartimin e këtij specifikimi teknik i janë referuar standardeve që ka përcaktuar Ligji i Prokurimit Publik, si dhe kanë përdorur një standard të kombinuar. Studimi i tregut i bërë për hartimin e specifikimit teknik nuk është i dokumentuar, por në të gjitha specifikimet është vendosur minimum dhe nuk është vendosur kufi nga një vlerë në një vlerë, në mënyrë që të mbyllet, të shtrembërohet ose që të drejtohet drejt një marke të caktuar. Ankesa e OE e cila lidhet me uljen e cilindratës dhe fuqisë motorrike dhe rritjen më pas të konsumit të karburantit është një ankesë e pabazë, pasi këto parametra nuk ecin në logjikë me njëra-tjetrën. OE ankimes kur kërkon ulje të cilindratës dhe të fuqisë motorrike duhej që të kërkonte dhe uljen e konsumit të kombinuar të karburantit për 100 km., kështu që ky pretendim nuk qëndron.

Po ti referohemi specifikimeve teknike të cilindratës dhe të fuqisë motorrike të përcaktuar nga ana jonë ne kemi kërkuar “KONSUM TË KOMBINUAR” duke marrë një të mesme të të gjithë tregut dhe pa lënë me një anë mjetet që pretendon OE ankimes. Ne nuk kemi lëvizur nga standardi European i kërkesave për këtë punë, ku në pasaportën e mjetit për këto tipe mjetesh konsumi i kombinuar i karburantit është 8 litra. Këtu nuk po flasim pastaj për raste të veçanta dhe specifike dhe ajo që tha inxhinieri më parë që tek ankesa për punën e karburantit OE ka një dislogjikë një jollogjikë, pasi nuk mundet që të realizosh fuqi motorrike më të madhe me një cilindratë më të vogël dhe të harxhosh më shumë karburant. Kjo inxhinierikisht nuk shkon dhe nuk ka sens.”, duke mos arritur që të argumentojë se si e ka bërë studimin e tregut, se cilën metodë të përcaktuar në nenin 36 të LPP-së ka përdorur, si dhe se si ndikon pranimi i pretendimit të ankimesit në terma funksionale, ndërkohë që vetë përfaqësuesi i autoriteti kontraktor në seancë pranoi se ky specifikim teknik është hartuar duke marrë një të mesme të të gjithë tregut, ndërkohë që kjo metodë nuk është e saktë, pasi përjashton automjetet të këtij tipi që janë studiuar nga ana e autoritetit kontraktor, por që kanë konsum më të lartë se mesatarja e përllogaritur nga specialistët e fushës.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon, se për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë do të sigurojnë mall cilësor në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, por një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të justifikojë kërkesën për “**Konsumi i kombinuar për 100 km Max 8 litra /100km.**” për automjetin “Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)” objekt-prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP-së si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk

duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin teknik “*Konsumi i kombinuar për 100 km Max 8 litra /100km.*” për automjetin “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*” të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, sipas pretendimeve të ankimesit.

Pretendimi i operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK qëndron.

III.3.9.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK për sa i përket modifikimit të specifikimit teknik lidhur me parametrin e “*Lartësia nga toka*” të automjeteve “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*”, “*Automjet tipi 2*” dhe “*Automjet tipi 3 SUV*” të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ky i fundit ka parashtruar argumente të bazuara, në lidhje me kërkesat e mësipërme. Nga shqyrtimi i procesverbalit “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht hartimin dhe vendosjen e këtij specifikimi teknik. Nga ana tjetër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave lidhur me këtë pretendim të ankimesit me vendimin nr. 8086/5 prot., datë 13.11.2023 ka argumentuar se: “*Lidhur me:*

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Lartësia nga toka Min 200 mm", është kriter që lidhet me parametra të tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime. KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikimet teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standarde e automjetit nga toka (Ground Clearance) për mjete me parametra teknikë, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 200 mm dhe jo 180 mm, sikurse pretendon në ankesë OE.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (kriteret teknike/përmasat) për Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabinë) sasia 14 (katërbëdhjetë) copë të reja me zero Kilometra, nuk qëndron.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Lartësia nga toka Min 200 mm", është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime. KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikime teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standarde e automjetit nga toka (Ground Clearance) për mjete me parametra teknikë, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 200 mm dhe jo 180 mm, sikurse pretendon në ankese OE.

KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Lartësia Min 1800 mm" është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime.

KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikimet teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standard e automjetit nga toka (Height) për mjete me parametra teknike, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 1800 mm dhe jo 1690 mm, sikurse pretendon në ankesë OE.

*KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "**Lartësia nga toka Min 180 mm**", është kriter që lidhet me parametrat e tjerë teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për të cilët OE nuk ka pretendime.*

KSHA, nga një vlerësim/kërkim në ueb për specifikime teknike të automjeteve - objekt prokurimi, për marka të ndryshme, konstaton se lartësia standarde e automjetit nga toka (Ground Clearance) për mjete me parametra teknikë, sipas kërkesës së AK, është më e madhe se 180 mm dhe jo 170 mm, sikurse pretendon në ankesë OE.", duke mos arritur që të argumentojë se ku është mbështetur në hartimin dhe përcaktimin e këtij specifikimi teknik, si dhe nuk ka arritur të argumentojë teknikisht në terma funksionale se përse minimumi i madhësisë së cilindratës është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe se si ky specifikim është i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të autoritetit kontraktor lidhur me realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Lidhur me metodologjinë e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për hartimin e këtij specifikimi Teknik për automjetet objekt-prokurimi, Komisioni më datë 05.12.2023, ora 12:00 zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe të ankimuesit, ku referuar pyetjeve të mëposhtme të Komisionit si në vijim: "1- Si janë hartuar specifikimet teknike nga ana e autoritetit kontraktor për mallrat objekt-prokurimi, sipas kontratës së shërbimit të kërkuar?; 2- Cilës prej metodave të parashikuara në nenin 36 të LPP-së, i është referuar AK në hartimin e specifikimeve teknike? Dhe 3- A ka kryer AK studim tregu në përputhje me parashikimin e nenit 35 të LPP-së dhe gjatë hartimit të këtyre specifikimeve teknike dhe studimit të tregut (në rast se është kryer nga ana e AK-së) a është vlerësuar se në mënyrë të kombinuar këto specifikime teknike mund të çojnë drejt një marke të posaçme?; 4-Pse është kërkuar kjo lartësi? dhe 5-Si ka arritur AK në përcaktimin e këtij specifikimi Teknik dhe cilën metodë ka ndjekur dhe cilat janë rastet që AK ka parë gjatë studimit të tregut dhe pse një lartësi e një niveli të ndryshëm mundet të mos realizojë funksionin e kërkuar nga AK?", përfaqësuesit e autoritetit kontraktor bënë me dije se: "Në hartimin e këtij specifikimi teknik i janë referuar standardeve që ka përcaktuar Ligji i Prokurimit Publik, si dhe kanë përdorur një standard të kombinuar. Studimi i tregut i bërë për hartimin e specifikimit teknik nuk është i dokumentuar, por në të gjitha specifikimet është vendosur minimum dhe nuk është vendosur kufi nga një vlerë në një vlerë, në mënyrë që të mbyllet, të shtrembërohet ose që të drejtohet drejt një marke të caktuar. Siç thashë edhe në fillim, ne kemi një flotë aktualisht prej disa tipesh makinash dhe duke ju përshtatur edhe terrenit ku operojmë është kërkuar kjo lloj lartësie nga toka, sepse duke parë që mjetet tona hasin vështirësi ku disa prej tyre për terrene të caktuara normalisht kemi kërkuar rritjen e lartësisë nga toka. Nuk ka një standard ndërkombëtar. Lartësia është karakteristikë e prodhuesit dhe kërkesa jonë për të patur një lartësi minimale të caktuar lidhet me gjendjen e rrugëve ku do operojnë këto mjete dhe me ku këto mjete do të përdoren dhe për transportin e mallrave specifike të një rëndësie të veçantë si; pompa thellësie, apo pjesë pompash, së bashku me veglat e punës dhe të cilat edhe rrezikojnë ndonjë dëmtim për shkak të rrugës, pra kemi bërë një kombinim të kësaj natyre dhe besoj se këto shkojnë njëra pas tjetrës me karakteristikën dhe tipin e mjetit që kemi kërkuar.", duke mos arritur që të argumentojë se si e ka bërë studimin e tregut, se cilën metodë të përcaktuar në nenin 36 të LPP-së ka përdorur, si dhe se si ndikon pranimi i pretendimit të ankimuesit në terma funksionale, ndërkohë që vetë përfaqësuesi i autoritetit kontraktor nga njëra anë shprehet se në hartimin e këtij specifikimi kanë përdorur një standard të kombinuar, ndërsa nga ana tjetër shprehet se nuk ka një standard për përcaktimin e këtij specifikimi Teknik, duke

qenë konfuz dhe i paqartë në argumentet e dhëna dhe për më tepër nuk arrin të argumentojë teknikisht se përse modifikimi i lartësisë së këtyre mjeteve sipas pretendimit të ankimuesit do të çonte në mosrealizimin e qëllimit të entit prokurues për të cilën po realizon këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon, se për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë do të sigurojnë mall cilësor në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, por një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të justifikojë kërkesën për “*Lartësia nga toka*” për secilën prej automjeteve objekt-prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP-së si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin teknik të “*Lartësia nga toka*” për automjeteve “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*”, “*Automjet tipi 2*” dhe “*Automjet tipi 3 SUV*” të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, sipas pretendimeve të ankimuesit.

Pretendimet e operatorit ekonomik “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*AUTO FRANCE – AL*” SHPK për specifikimet teknike si në vijim: “Xhamat me nuance dhe Xhamat e errët mbrapa” për automjetin objekt-prokurimi “*Automjet tipi 2 SUV*”, si dhe pretendimin e ankimuesit lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që automjetet objekt-prokurimi “*Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine)*” “*Automjet tipi 2 SUV*” dhe “*Automjet tipi 3 SUV*” të kenë të instaluar sistemin GPS të inkorporuar, të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçovë, QPN Fier dhe QPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe QFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jenë “Mjete tip fuoristrada” dhe me karroceri të lehtë ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik .

Flota aktuale që kanë si qendrat e prodhimit dhe ato mbështetëse nuk arrijnë të mbulojnë punën voluminoze. Në programin e zhvillimit të shoqërisë Albpetrol sha të miratuar për vitin 2023 është parashikuar edhe marrja me qira operationale (leasing) të 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjeteve fuoristrada për një periudhë 4(katër) vjecare.

Specifikimet per automjetet:

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- | | |
|----------------------------------|-----------------------------|
| - Viti prodhimit/km | <u>Min viti 2022 / 0 km</u> |
| - Cilindrata | <u>Min 2200 cc.</u> |
| - Lenda djegese | Naftë. |
| - Fuqia motorike | <u>Min 110 Kw.</u> |
| - Numri i cilindrave | Min 4 |
| - Konsumi i kombinuar per 100 km | <u>Max 8 litra /100km.</u> |

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kamio) Manuale.
- Terheqja 4x4.

Permasat e autovetures:

- Gjatesia Min 5 200 mm
- Lartesia nga toka Min 200 mm
- Gjeresia Min 1 800 mm
- Lartesia Min 1 700 mm
- Distanca aksiale Min 3 000 mm

Gabina:

- Numri i dyerve 4
- Numri i vendeve Min 4+1

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS.
- Sistem ASR, ESP
- Airbeg per shoferin dhe pasagjerin.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Radio
- Pedanat anesore
- Tempomat
- Disqe alumini min 16

Ngjyra e negocueshme ne lidhjen e kontrates

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km Min viti 2022 / 0 km
- Cilindrata Min 2200 cc.
- Lenda djegese Naftë.
- Fuqia motorike Min 140 kë.
- Numri i cilindrave Min 4
- Konsumi i kombinuar per 100km Max 10 litra /100km.

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kambio) Automatike
- Terheqja 4x4.

Permasat e autovetures:

- Gjatesia Min 4800 mm
- Lartesia nga toka Min 200 mm
- Gjeresia Min 1900 mm
- Lartesia Min 1800 mm
- Distanca aksiale Min 2800 mm

Gabina:

- Numri i dyerve $\frac{4}{}$
- Numri i vendeve $\text{Min } 4+1$

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR, EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18"
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bloutooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesis per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome
- Sedilje lekure
- Kamera mbrapa

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates

Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km $\text{Min viti } 2022 / 0 \text{ km}$
- Cilindrata $\text{Min } 1600 \text{ cc.}$
- Lenda djegese Naft.
- Fuqia motorike $\text{Min } 100 \text{ kw.}$
- Numri i cilindrave $\text{Min } 4$
- Konsumi i kombinuar per 100km $\text{Max } 7 \text{ litra } /100\text{km.}$

Transmisioni:

- Kutia e shpejtises(Kamio) Automatike
- Terheqja $2x4.$

Permasat e autovetures:

- Gjatesia $\text{Min } 4400 \text{ mm}$
- Lartesia nga toka $\text{Min } 180 \text{ mm}$
- Gjeresia $\text{Min } 1800 \text{ mm}$
- Lartesia $\text{Min } 1600 \text{ mm}$
- Distanca aksiale $\text{Min } 2600 \text{ mm}$

Gabina:

- Numri i dyerve $\frac{4}{}$
- Numri i vendeve $\text{Min } 4+1$

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR,EDB
- Airbag min 6 cope.

- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bloutooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesisie per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates.

- *Oferta ekonomike e OE, duhet të ketë të përfshirë:*
 - Të gjitha shpenzimet e nevojshme për importin e automjeteve dhe pagesës së detyrimeve doganore, sipas legjislacionit në fuqi.
 - Të gjithë shpenzimet e nevojshme për regjistrimin e automjeteve pranë institucioneve përkatëse, targimin e automjeteve dhe dokumentacionin e duhur ligjor si: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, etj.
 - Të gjithë shpenzimet vjetore për taksat e qarkullimit, siguracionin e detyrueshëm TPL, kolaudimin, siguracionin Kasko, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.
 - Të gjithë shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, si:
 - Ndërrim i vajit të motorrit, filtrave të tjerë (karburantit, vajit, ajrit, kondicionerit, etj.) sipas afatit te manualit te automjetit.
 - Ndërrim i vajit të kambios, sipas afatit te manualit te automjetit.
 - Ndërrimin e pjesëve të konsumit të automjeteve, në varësi të përdorimit të tyre, si ferrota, alkol frenash, alkol të sistemit të drejtimit, etj.
 - Ndërrimin e gomave sipas normativës së konsumit te ndërrimit pas përshkruarjes se kilometrave përkatëse.
 - Riparimin e automjeteve kur kjo është e nevojshme.

Marrja me qira e automjeteve kërkohet për një periudhë 48 (dyzet e tetë) muaj nga data e dorëzimit të automjeteve.

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruajë të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operationale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qira operationale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marri masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Marja me qira e mjeteve do të jetë për një periudhë 48 mujore, pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për 48 muaj me një planifikim 12 mujor afërsisht 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajte të imazhit të institucionit. Mbi këtë vlerësim Albpetrol sha ka planifikuar marrjen me qira operationale të një sasie mjetesh rrugore.

Gjithashtu Ofertuesi ka për detyrë:

- j. Menaxhimin e gjithë dokumentacionit të makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj.*
- k. Menaxhimin e gjithë procesit të sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash.*
- l. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit.*
- m. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike.*
- n. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve.*
- o. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje.*
- p. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira me specifikimet teknike në DST) brenda 48 oreve.*
- q. Asistenca teknike e ofruar dhe shërbimi i emergjencës 24 ore*
- r. Menaxhim flote me anë të inkorporimit të sistemit GPS.*

III.3.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, autoriteti kontraktor argumentuar përcaktimin e specifikimeve teknike objekt-ankimi si më poshtë vijon:

“II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.”.

III.3.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “AUTO FRANCE – AL” SHPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes me vendimin nr. 8086/5 prot., datë

13.11.2023, drejtuar ankimesit është shprehur se: “KSHA vlerëson se lidhur me aksesoret shtesë për nuancën e xhamave apo errësimin e xhamave të prapëm argumentojmë se këta janë aksesore standard që plotësohen nga pjesa më e madhe e prodhuesve të automjeteve. Për Autoritetin Kontraktor e rëndësishme është që mjetet të plotësojnë kërkesat e tij nga ana funksionale dhe nuk është kërkuar përqindja e nuancës apo errësimin të xhamave, parametra që përcaktohen me akte nenligjore. Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit në lidhje me dokumentet e tenderit (kriteret teknike/përmasat) për Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (një) e re me zero kilometra, nuk qëndron”, duke mos i pranuar këto pretendime të ankimesit, ndërkohë që lidhur me pretendimin për kërkesën e autoritetit kontraktor që automjetet objekt-prokurimi të kenë të instaluar sistemin GPS të inkorporuar, nuk i ka kthyer përgjigje ankimesit.

III.3.4. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes “AUTO FRANCE – AL” SHPK në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 05.12.2023, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimes lidhur me specifikimet teknike si në vijim: “Xhamat me nuance dhe Xhamat e errët mbrapa” për automjetin objekt-prokurimi “Automjet tipi 2 SUV” u shpreh se: “Teorikisht sqarimi është i mjaftueshëm, por unë mendoj që nuk duhej të ishte si kriter.”, ndërsa lidhur me sistemin GPS përfaqësuesi i autoritetit kontraktor sqaroi, se jo detyrimisht ky sistem duhet të jetë i inkorporuar nga prodhuesi i automjeteve, por ky sistem mund të instalohet edhe nga jashtë, mjaft që të realizojë qëllimin e entit prokurues për monitorimin e këtyre mjeteve.

III.3.5. Referuar sa më sipër, KPP gjykon, se lidhur me pretendimet e mësipërme të ngritura në formën e sqarimit, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre, ka sqaruar ankimesin në mënyrë shteruese duke shmangur çdo konfuzioni në radhët e operatorëve ekonomikë dhe njëherazi për lehtësinë e punës së KVO në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e mësipërme të sqaruara nga ana e autoritetit kontraktor, pasi nuk ekziston më objekti i ankesës.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AUTO FRANCE - AL” SHPK për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose

916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "AUTO FRANCE - AL" SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

